DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

A-597972

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	“Qeverinë e merr Balluku”, Curri zbulon prapaskenat e Asamblesë së PS: Gogu ka 24 orë kohë |
ADRESA	`https://boldnews.al/2026/11/12/qeverine-e-merr-balluku-curri-zbulon-prapaskenat-e-asamblese-se-ps-gogu-ka-24-ore-kohe/`
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	12 nëntor 2026, 21:54:15 UTC *Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.*
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 nëntor 2026, 21:53:18 UTC *Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.*

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	`a825742599fa5a76fdb2061761b6143227190d97aa38257add6185a817c12f92`
TEKSTI	`67a17642238d34b93378d894451e7e0f4de4fa8a3280752698d0f47e4bc4bce9`
PAMJA	`09513db5e3370368fd93ae09eea4acdaabbb6445e6b147c83c070ac1a751b51a`

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	`affb6bc0cd01b8a0b7452644e0be3681f19a7a6c2d867af63f1a59befa884420`
E MËPARSHMJA	–
RRËNJA MERKLE	`bb10aa1e14f8c35ca185f953e57b9b5e9bbdf700fb6f73f3fa96ae5b3417a430`
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok *Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.*

SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/affb6bc0cd01b8a0b7452644e0be3681f19a7a6c2d867af63f1a59befa884420`

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Qeverinë e merr Balluku”, Curri zbulon prapaskenat e Asamblesë së PS: Gogu ka 24 orë kohë

22:53 : 12/11/2026 në AKTUALITET, POLITIKE



Lexo edhe:

Abilekaj: Kushtetusja po merr kompetencat e institucioneve të drejtësisë

“Kush e çoi Veliajn në burg?”, Bushati: Rama ose urdhëroi SPAK-un, ose i dha sinjalin

Analisti Arjan Curri ka zbuluar një skenar të mundshëm për ndryshime në kabinetin qeveritar, në prag të Asamblesë së Partisë Socialiste, që pritet të mbahet të shtunën.

I ftuar në emisionin “Top Story”, Curri pretendoi se disponon informacione për një takim mes kryeministrit Edi Rama dhe Belinda Ballukut, gjatë të cilit kjo e fundit dyshohet se ka kërkuar rishpërndarjen e posteve dhe rritjen e ndikimit të saj në qeveri.

Sipas versionit të paraqitur nga analisti, takimi është zhvilluar me kërkesë të Ramës, i cili ka diskutuar me Ballukun për vendimet që pritet të merren në Asamblenë e PS-së.

Curri pretendoi se Balluku i ka kërkuar kreut të qeverisë të rishikojë përbërjen e kabinetit, duke vënë në diskutim edhe qëndrimin e ministrit të Drejtësisë, Toni Gogu. Në këtë skenar, sipas tij, është përmendur mundësia e largimit të Gogut dhe rikthimi i Vëngut në një post qeveritar.

Analisti përmendi gjithashtu emrat e ministrit të Financave, Petrit Malaj, dhe ministrit të Jashtëm, Ferit Hoxha, si pjesë të një skenari të pretenduar për rishpërndarjen e përgjegjësive ministrore.

Një tjetër pretendim i Currit lidhej me raportet e pushtetit brenda Partisë Socialiste. Ai sugjeroi se Balluku mund të kërkojë një rol më të madh në vendimmarrjen qeveritare, duke e përshkruar konfigurimin e mundshëm si një qeveri Rama-Balluku.

Në deklaratën e tij, analisti përmendi edhe SPAK-un dhe GJKKO-në, duke pretenduar se gjatë bisedës është diskutuar ndikimi që mund të kenë aktorë të ndryshëm në zhvillimet politike.

TË GJITHA


“Qeverinë e merr Balluku”, Curri zbulon prapaskenat e Asamblesë së PS: Gogu ka 24 orë kohë
22:53 : 12/11/2026


“Air Albania” shpërthen në festë, Shqipëria mposht Finlandën 2-0
22:43 : 12/11/2026


9 anëtarë të delegacionit somalez zhduken pas mbërritjes në Prishtinë
22:42 : 12/11/2026


Abilekaj: Kushtetusja po merr kompetencat e institucioneve të drejtësisë
22:34 : 12/11/2026


“Kush e çoi Veliajn në burg?”, Bushati: Rama ose urdhëroi SPAK-un, ose i dha sinjalin
22:18 : 12/11/2026


Manaj godet Finlandën, Shqipëria kryeson 2-0
22:04 : 12/11/2026


Vrasjet e bujshme dhe dosja e SPAK, Hoxha: Kush dha urdhrin, kush financoi dhe kush i ekzekutoi?
22:02 : 12/11/2026

Megjithatë, Curri theksoi disa herë se informacionet që disponon nuk janë të konfirmuara dhe se mund të jenë edhe pjesë e një skenari për të zhvendosur vëmendjen nga zhvillimet e tjera politike.

Ai parashikoi se Asambleja e së shtunës mund të sjellë lëvizje të rëndësishme në qeveri, ndërsa hodhi edhe pretendimin se Toni Gogu ka vetëm 24 orë kohë për të bindur Ballukun për pozicionin e tij.

“Kam informacione totalisht të ndryshme për një takim të zhvilluar mes Ramës dhe Ballukut, është bërë me thirrjen e të parit dhe Rama i ka thënë Ballukut se çfarë do të bëjmë në Asamble.

Balluku sipas informacioneve të mia ka thënë: ‘Dëgjo Edi, kam zhdukur të gjithë armiqtë e tu, Veliajn që deshi të ndizte protestat, Spiropalin që të shau deri në Gjermani, Sara Milen që të kërcënonte me të fortët e Elbasanit. A ka kuptim të ndajmë qeverinë mes disa aksionerëve? Çfarë do të bëjmë me Gogun, do ta mbajmë akoma? Po sikur ta heqim atë dhe të kthejmë Vëngun?’ Ju e dini që shefja i emëron drejtorët, sipas investigimit të Fiks Fare.

Përse të mos i japim Malajt edhe Ekonominë dhe Mjedisin? Gogu me shumë mundësi do të hiqet pasnesër. Përse të mos i japim Karakaçit edhe postin e ministrit të jashtëm? Këto informacione nuk i kam të konfirmuara, mund të jenë për të shpërndarë vëmendjen.

Ajo i ka thënë që ka SPAK-un dhe GJKKO-në, merr këta 4-5 të mitë dhe e ke ti në dorë. Me shumë mundësi do të kemi një qeveri Balluku-Rama pas kësaj. Unë them se pasnesër qeverinë e merr të gjithën Balluku. Toni Gogu ka 24 orë që të bindë Ballukun se nuk është vetëm me Ramën, por edhe me të”, u shpreh Curri.

Etiketa: asambleja e ps | Belinda Ballukut | Edi Rama | Petrit Malaj | Toni Gogu

Lajme të lidhura




Abilekaj: Kushtetusja po merr kompetencat e institucioneve të drejtësisë

22:34 : 12/11/2026




“Kush e çoi Veliajn në burg?”, Bushati: Rama ose urdhëroi SPAK-un, ose i dha sinjalin

22:18 : 12/11/2026



“Rama jepe dorëheqjen”- Tifozët thirrje kundër kryeministrit edhe në “Air Albania”/ VIDEO

21:56 : 12/11/2026



Avokati: Veliaj nuk ka kallëzuar Ramën, por drejtoreshën e burgjeve

21:48 : 12/11/2026



Asambleja e PS-së, Lubonja nuk pret asnjë ndryshim: Janë kukulla, Rama vendos me ata që janë pas skenës

21:43 : 12/11/2026



Gonxhja i vë syrin Bashkisë së Tiranës, i çon sinjale Ramës: E njoh mirë

20:55 : 12/11/2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.